



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:236771
Datë: 25.11.2024
Numri i dokumentit: 06505399

P.nr.2024:236771

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Samedin Cena, me bashkëpunëtorin profesional Sefedin Avdijaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. K. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP/II.nr.1070/24 të datës 29.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 13.11.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Qazim Kuqi dhe të akuzuarit R. K. së bashku me mbrojtësin e tij avokat Teki Bokshi nga Gjakova, me datë 15.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

R. K., data e lindjes. . . në Gjakovë, me banim në fshatin . . . Komuna e Gjakovës rr “Ardhmëria”, pa numër nga i ati Xh e ëma S, e vajzërisë A, i martuar, babai i 3 fëmijëve , i papune, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e fillore, me numër personal . . ., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Sepse me datë 28.07.2024 rreth orës 23:00/h në fshatin . . ., Komuna e Gjakovës, pikërisht në shtëpinë e vëllaut të tij, i pandehuri në kundërshtim me ligjin Nr.05/L-022 për armët, përdor armën me gaz të tipit “Valtro Mod 85 Combat”, me numër serik A17543, në atë mënyrë që, natën kritike i pandehuri kishte festë në familje pasi është martuar nipi i tij dhe

në shenjë gëzimi i njëjti largohet nga turma dhe e nxjerr armën të cilën e kishte të vendosur në çantën e tij dhe shkrep katër (4) herë në ajër për t'u identifikuar më pas nga zyrtarët policorë ashtu që e njëjta armë së bashku me një (1) karikatorë dhe katër (4) gëzhoja të kalibrit 9 mm, sekuestrohen nga ana e zyrtarëve policorë.

- Me këtë ka kryer veprë penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II. Sepse pasi më parë ka siguruar e gjerë me datë 28.07.2024 rreth orës 23:20 minuta në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, pa autorizim ka poseduar armë dhe municion në kundërshtim me ligjin Nr.05/L-022 për armët, në atë mënyrë që, natën kritike pasi policia identifikon të njëjtin se e ka përdorur armën si në pikën I të dispozitivit, i njëjti e pranon se ka në pronësi armën me gaz të tipit “Valtro Mod 85 Combat”, me numër serik A17543 së bashku me një (1) karikatorë dhe katër (4) gëzhoja të kalibrit 9 mm i cili i dorëzon vullnetarisht pasi e kishte në çantën e tij të krahut për të cilën i pandehuri i ka mbajtur në posedim pa leje nga organi kompetent e cila më pas është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policorë.

- Me këtë ka kryer veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,43,48,69,70 të KPRK-së dhe neneve 242, 269, 358, 364 e 365 të KPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT

Ashtu që i përcaktohet:

- I. Për veprën penale nga pika I e dispozitivit i shqiptohet Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuari në afatin prej vitësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Për veprën penale nga pika II e dispozitivit i shqiptohet Dënimi me gjobë në shumën prej tetëqind (800) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej gjashtëdhjetë 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Gjukata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryen një apo më shumë vepra penale.
- IV. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguajë gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do ta zëvendësojë me dënim me burg në

kohëzgjatje prej dyzet (40) ditësh, ku një ditë me burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës.

- V. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- VI. Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, konfiskohet arma e tipit “Valtro Mod 85 Combat”, me numër serik A17543, me një (1) karikatorë dhe katër (4) gëzhoja të kalibrit 9 mm.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën me numër PP/IL.nr.1070/24 të datës 29.08.2024, kundër të akuzuarit R. K. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata për këtë çështje juridiko penale me datë 13.11.2024 ka mbajtur shqyrtimin fillestar për të akuzuarin R. K. për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi dhe i akuzuari R. K. me mbrojtësin e tij avokat Teki Bokshi nga Gjakova.

I akuzuari R. K. pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favorët dhe pasojat e pranimin të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoj fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzë dhe atë për të dy veprat penale, na vjen keq për rastin që ka ndodhur, për të cilën vepër jam penduar pa masë, shprehë keqardhje për dëmin që i kam shkaktuar dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej ma vepër penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat Teki Bokshi lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se dakordohem në tërësi me pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe i njëjti pranim ka ardhur pas konsultimeve, andaj gjykatës i lutem që me rastin e caktimit të sanksionit penal të merr parasysh faktin se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, është babai i tre fëmijëve të mitur dhe mbajtës i vetëm i familjes, se armën policisë ia ka dorëzuar në mënyre vullnetare, se ka shprehur

pendesë për veprat e kryera dhe shpreh keqardhjen dhe premtimin se në të ardhmen vepra të tilla apo të ngjashme nuk do të përsëriten, andaj gjykatës i lutem që të shqiptojë një sanksion sa më të lehtë, me të njëjtin do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe duke pasur parasysh se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale.

Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari, meqenëse i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe benifitet e këtij pranimi të fajësisë, andaj gjykatës i propozojmë që të aprovojë këtë pranim të fajësisë dhe të njëjtin ta dënojë sipas ligjit duke vlerësuar njëherit rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të cilat janë të cekura edhe në aktakuzë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjyqtari i çështjes në shqyrtim fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilën ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari R. K. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë pranimi të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana Gjykatës për pasojat dhe favorët e pranimi të fajësisë si dhe duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë gjykata nuk është lëshuar në procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari R. K. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367, par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datë 28.07.2024 rreth orës 23:00/h në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, pikërisht në shtëpinë e vëllaut të tij, i pandehuri në kundërshtim me ligjin Nr.05/L-022 për armët, përdor armën me gaz të tipit “Valtro Mod 85 Combat”, me numër serik A17543, në atë mënyrë që, natën kritike i pandehuri kishte festë në familje pasi është martuar nipi i tij dhe në shenjë gëzimi i njëjti largohet nga turma dhe e nxjerr armën të cilën e kishte të vendosur në çantën e tij dhe shkrep katër (4) herë në ajër për t’u

identifikuar më pas nga zyrtarët policorë ashtu që e njëjta armë së bashku me një (1) karikator dhe katër (4) gëzhoja të kalibrit 9 mm, sekuestrohen nga ana e zyrtarëve policorë.

Po ashtu, i akuzuari R. K. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ashtu që nga data e pacaktuar e deri me datë 28.07.2024 rreth orës 23:20 minuta në fshatin . . ., Komuna e Gjakovës, pa autorizim ka poseduar armë dhe municion në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-022 për armët, në atë mënyrë që, natën kritike pasi policia identifikon të njëjtin se e ka përdorur armën si në pikën I të dispozitivit, i njëjti e pranon se ka në pronësi armën me gaz të tipit “Valtro Mod 85 Combat”, me numër serik A17543 së bashku me një (1) karikator dhe katër (4) gëzhoja të kalibrit 9 mm i cili i dorëzon vullnetarisht pasi e kishte në çantën e tij të krahut për të cilën i pandehuri e ka mbajtur në posedim pa leje nga organi kompetent e cila më pas është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policorë.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi edhe nga provat në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i policit F. B.i datës 29.07.2024; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të armëve i datës 28.07.2024; Deklarata e të pandehurit R. K. e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 29.08.2024; Fotografitë e armës së sekuestruar bashkë me karikator dhe fishekët; si dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

Në nenin 367 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm e kryen “*Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet*”.

5. Vendimi

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjyqtari i çështjes të akuzuarin R. K. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, e bazuar në këtë

ka vendosur që të akuzuarin të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e dobët ekonomike, i vetëdijshëm për rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo veprë penale, është penduar thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsëritë këtë veprë penale dhe faktin se është mbajtës i familjes. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes për rastin që i ka ndodhur si dhe faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe faktin se ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjatë nxjerrjes së këtij vendimi gjykata mori parasysh peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

8. Vendimi për konfiskim

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, konfiskohet arma e tipit “Valtro Mod 85 Combat”, me numër serik A17543, me një (1) karikatorë dhe katër (4) gëzhoja të kalibrit 9 mm. e sekuestruar nga i akuzuari sipas Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 28.07.2024.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2024:236771, më datë 25.11.2024

Bashkëpunëtori profesional
Sefedin Avdijaj

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.